



## Ftesë për ofertë

**Titulli i ofertës: “Ofrimi dhe integrimi i shërbimeve e-KYC dhe Digital Signature”**

**Data e hapjes për ofertim: 12/03/2026**

**Data e mbylljes për ofertim: 27/03/2026**

AFK, në kuadër të strategjisë së saj për digjitalizim dhe automatizim të proceseve të kreditimit, fton operatorë të kualifikuar të paraqesin oferta për:

- Verifikim elektronik të identitetit të klientëve (e-KYC),
- Nënshkrim elektronik të dokumentacionit të kredive (Digital Signature),
- Integrim të plotë teknik të këtyre shërbimeve me sistemet ekzistuese të AFK-së (website dhe mobile app).
- Qëllimi është të mundësohet **onboarding i plotë digjital, remote dhe i sigurt**, pa nevojë prezence fizike të klientit.

### Shërbimet e kërkuara:

Shërbimi e-KYC (Electronic Know Your Customer)

Operatori duhet të ofrojë një zgjidhje e-KYC që përfshin, por nuk kufizohet në:

- Identifikim elektronik i klientëve në distancë (remote identification);
- Verifikim i dokumenteve të identitetit (ID card / pasaportë);
- Verifikim biometrik (selfie + krahasim me dokument);
- Liveness detection për parandalim të mashtrimeve;
- Audit trail dhe logim të plotë të procesit të identifikimit;
- Mundësi për ripërdorim të identitetit të verifikuar për shërbime të tjera (pa re-KYC)

### Shërbimi duhet të jetë në përputhje me:

- rregulloret AML/KYC,
- GDPR,
- standardet evropiane për identifikim elektronik (eIDAS ose ekuivalente).

## **Shërbimi i Nënshkrimit Elektronik (Digital Signature)**

Operatori duhet të ofrojë shërbime të nënshkrimit elektronik që përfshijnë:

- Advanced Electronic Signature (AdES) dhe/ose
- Qualified Electronic Signature (QES), sipas nevojës së procesit të kreditimit;

Karakteristikat minimale të kërkuara:

- Vlerë ligjore e barabartë me nënshkrimin fizik (sipas legjislacionit në fuqi);
- Nënshkrim i dokumenteve PDF dhe formateve të tjera standarde;
- Mundësi nënshkrimi përmes web dhe mobile app;
- Autentikim i nënshkruesit (OTP, aplikacion mobil ose ekuivalent);
- Timestamp dhe integritet i dokumentit pas nënshkrimit.

## **Integrimi Teknik**

Operatori duhet të sigurojë:

- API / SDK për integrim me:
- website-in e AFK-së,
- mobile application (iOS & Android);
- Dokumentacion teknik të plotë (API docs);
- Mbështetje gjatë fazës së implementimit;
- Test environment (sandbox);
- Siguri e lartë e të dhënave dhe enkriptim end-to-end.

**Zgjidhja duhet të mundësojë:**

- Aplikim online për kredi,
- e-KYC gjatë aplikimit,
- Nënshkrim digjital të kontratës së kredisë,
- Ruajtje dhe verifikim të dokumentacionit në mënyrë digjitale.

## **Kushtet e përgjithshme:**

- Licencim dhe/ose autorizim për ofrimin e shërbimeve e-KYC dhe Digital Signature;
- Përputhshmëri me:
  - GDPR,
  - AML/KYC,
  - eIDAS (ose standarde ekuivalente ndërkombëtare);
- Përvojë të mëparshme me institucione financiare, banka, ose fintech.

**Oferta duhet të përmbaj informatat si në vijim:**

- Përshkrim të kompanisë dhe përvojës relevante;
- Përshkrim teknik të zgjidhjes së propozuar;
- Arkitekturë e zgjidhjes dhe mënyra e integritimit;
- Modelet e nënshkrimit elektronik që ofrohen;
- Afatet e implementimit;
- Modelin e çmimeve (setup, kosto për transaksion, abonim, etj.);
- SLA dhe mbështetje teknike.

**Kushtet dhe rregullat e tenderit:**

- Të gjitha ofertat origjinale të dërgohen të mbyllura në zarf në adresën e zyrës qendrore të AFK-së në Pejë: Rruga "Lidhja e Prizrenit "Nr.20, kodi postar 30 000, ose përmes postës elektronike [prokurimi@afkonline.org](mailto:prokurimi@afkonline.org) ,në format elektronik (PDF)
- AFK rezervon të drejtën të kërkojë sqarime shtesë ose të refuzojë çdo ofertë që nuk përmbush kriteret e përcaktuara.
- Kjo ftesë nuk obligon AFK-në të përzgjedhë domosdoshmërisht ndonjë ofertë dhe nuk krijon detyrim kontraktual deri në nënshkrimin e një kontrate formale.

**Afati i fundit i pranimit të ofertave: 27/03/2026 ora 16:00.**

*AFK mban të drejtën për anulimin ose ndryshimin e këtij tenderi në çdo kohë!*